

URDHËR
Nr. 239, datë 19.3.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Z. Endri Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, i delegohet kompetenca e nënshkrimit të dokumenteve që njoftojnë institucionet fondkrijuese për dërgimin e inspektorit për asistencë, nëse plotësohet kushti që asistenca zhvillohet nga inspektori që është person kontakti i atij fondkrijuesi.
 2. Kompetenca e deleguar do të ushtrohet deri në një urdhër të dytë.
 3. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve z. Endrit Musaj.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardi Bido